

## 4.6 PËRZGJEDHJA E FORMATIT PËR SHFAQJEN E REZULTATEVE TË KËRKIMIT

Rezultatet e kërkimit shfaqen në pjesën e poshtme të dritares për kërkim. Ato shfaqen në formate të ndryshme, varësisht nga numri i regjistrimeve bibliografike të shfaqura.

### *Procedura*

1. Te "Formati i listës së rezultateve të kërkimit" zgjidhni formatin e paraqitjes së rezultateve. Këtë mund ta bëni para se të filloni kërkimin ose pas përfundimit të kërkimit.

Formati i përzgjedhur i shfaqjes së rezultateve të kërkimit ruhet për t'u përdorur te kërkimet e tjera (derisa të mos e ndryshoni atë).

Numri i regjistrimeve bibliografike, të cilat janë shfaqur në rezultatet e kërkimit, është i paracaktuar ose atë e cakton vet kataloguesi.

Për të gjitha burimet paraprakisht është definuar formati i paracaktuar, i cili përmban të dhëna për identifikimin bazë të burimit dhe regjistrimit bibliografik, si dhe formati që përmban të dhëna të hollësishme, të nevojshme për shkarkimin e regjistrimeve.

Llojet e ndryshme të formateve mund t'i përcaktoni në shfletues (shih. kap. 12.1.2 dhe kap. 12.1.3).

Lista etributeve të përcaktuara paraprakisht me fushat dhe nënfushat përkatëse, nga të cilat mund të shfaqen të dhënat në formatin e rezultateve të kërkimit, ndodhet në shtojcën *E.1*.